



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, Komuna e Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale nr. 00930-205 me sipërfaqe 48 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00930-205, Zona Kadastrale Matiçan Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 035-186861, të dt. 02.10.2013.
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 00930-70 me sipërfaqe 48 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00930-70, Zona Kadastrale Matiçan Prishtinë, në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit, me destinim brezin e gjelbër të planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar me Vendimin nr. 01 nr.035-186861, të dt. 2.10.2013.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme me pronarët e cekur në pikën II të Vendimit, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar me Vendimin nr. 01 nr.035-186861, të dt. 2.10.2013.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të Pronës së paluajtshme të komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-204129/23, më 10.10.2023

KRYESHESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajçinovi



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-216183/21, dt. 11.11.2022, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e parcelës kadastrale nr. 930-205, sipërfaqe 205 m², Z.K Matiçan Prishtinë në pronësi të Komunës së Prishtinës, të cilat gjenden në kuadër të bllokut urban "A-4", sipas Planit rregullues "Prishtina e re – Zona Qendër", i miratuar me vendimin nr.01 nr. 035-186861, dt. 2.10.2013 dhe pjesa e parcelës kadastrale me nr. 930-70, me sipërfaqe 48 m², Z.K Matiçan Prishtinë, në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit, me destinim brez gjelbërues të planifikuar.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me vendimin nr. 01 nr.035-18686, dt. 2.10.2013. Parcela me nr.930-205 Zona Kadastrale Matiçan Prishtinë shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa pjesa e parcelës me nr. 930-70 me sipërfaqe 48 m², Z.K Matiçan Prishtinë, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me vendimin nr.01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013, shtrihen në brez gjelbërues të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.